




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PLANI
I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË NË KOMUNË
2019-2023

LIPJAN, 2019

PLAN
I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË NË KOMUNË 2019-2023

Hapat konkretë që Komuna e Lipjanit do të ndërmarr në funksion të përmbushjes së Planit të veprimit dhe rekomandimeve, përfshijnë objektivat si në vijim:

1. Informata lidhur me mbledhjet e rregullta të Kuvendit Komunal dhe Komiteteve
 2. Informata lidhur me mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal
 3. Informata lidhur me mbledhjet solemne të Kuvendit Komunal
 4. Konsultimet me publikun
 5. Takimet me publikun
 6. Takimet dhe intervistat e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ dhe gazetar
 7. E drejta e qasjes në dokumente publike
 8. Kërkesë për informim, iniciativat qytetare dhe petitionet
 9. Publikimi i akteve komunale
 10. Freskimi i web-faqës zyrtare të Komunës
 11. Qasja e shërbimeve për qytetarët transparent dhe shpejtë
 12. Prokurimi transparent - elektronik
 13. Procedurat e rekrutimit transparente
 14. Shpalljet për subvencionime transparente
 15. Njoftimet me raportet e organizatave tjera dhe takimet e Kryetarit sipas rregullativës ligjore
 16. Dita e hapur për qytetar
 17. Transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave të Kuvendi të Komunës në Livestream
 18. Konsultimi i publikut para miratimit të akteve të Kuvendit Komunal
 19. Numri kontaktues si dhe emaili zyrtar I Komunës
- Më hollësisht do të paraqiten objektivat e lartëshënuara në formë tabelare me elementet si në vijim:

1. Emërtimit të objektivit të planit të veprimit
 2. Aktivitetet e planit të veprimit
 3. Njësia/personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të Komunës
 4. Vendi i mbajtjes së aktiviteteve
 5. Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve komunale
- Plani I veprimit për transparencë në Komunë hartohet për 4 vite 2019-2023, në bazë të nenit 15 para. 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna.

	Objektiv i Planit të veprimit	Aktiviteti i planit të veprimit	Njësia/personi përgjegjës për publikimin e akteve dhe aktiviteteve të Komunës	Vendi i mbajtjes së aktivitetit	Afatet ligjore për shpallje publike të akteve dhe aktiviteteve të Komunës
1.	Informata lidhur me mbledhjet e rregullta të Kuvendit Komunal dhe Komiteteve	Njoftimi për mbledhje të rregullta të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve në: - webfaqen zyrtare - në vendet më të frekuentuara brenda teritorit të Komunës - në media të shkruara dhe elektronike - në rrjetet sociale	Sektori për Punë të Kuvendit dhe Sektori për marrëdhënie me publikun	Salla e Kuvendit të Komunës apo edhe salla të përshtatshme për pjesëmarrjen e qytetarëve	Njoftimi bëhet 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes
		Transmetimi i mbledhjes së Kuvendit Komunal në TV lokal dhe Radio			
2.	Informata lidhur me mbledhjet e	Njoftimi për mbledhje të jashtëzakonsh	Sektori për Punë të Kuvendit dhe	Salla e Kuvendit të Komunës apo	Njoftimi bëhet 3 ditë pune para mbajtjes së

	<i>jashtëzakonsh me të Kuvendit Komunal</i>	me të Kuvendit të Komunës në: - webfaqen zyrtare - në vendet më të frekuentuara brenda teritorit të Komunës - në media të shkruara dhe elektronike - në rrjetet sociale	Sektori për marrëdhënie me publikun	edhe salla të përshtatshme për pjesëmarrjen e qytetarëve	mbledhjes
3.	<i>Informata lidhur me mbledhjet solemne të Kuvendit Komunal</i>	Njoftimi për mbledhje të solemne të Kuvendit të Komunës në: - webfaqen zyrtare - në vendet më të frekuentuara brenda teritorit të Komunës - në media të shkruara dhe elektronike - në rrjetet sociale Transmetimi i mbledhjes së Kuvendit Komunal në TV lokal dhe Radio	Sektori për Punë të Kuvendit dhe Sektori për marrëdhënie me publikun	Salla e Kuvendit të Komunës apo edhe salla të përshtatshme për pjesëmarrjen e qytetarëve	Njoftimi bëhet sipas afatit ligjor
4.	<i>Konsultimet me publikun</i>	Komuna organizon konsultime të ndryshme që janë në interes të qytetarëve	Sektori për marrëdhënie me publikun në: - webfaqen e zyrtare të	Salla e Kuvendit të Komunës apo edhe salla të tjera të përshtatshme	Njoftimi bëhet 2 javë para takimit për konsultim me publikun

		si: - për buxhet lokal - zhvillim ekonomik lokal - planifikim hapësinor - investime - të hyra komunale - çështje tjera me interes për publikun	Komunës - rrjetet sociale - media të shkruara dhe elektronike - vendet e frekuentuara brenda teritorit të Komunës	për pjesëmarrjen e qytetarëve	
5.	<i>Takimet me publikun</i>	Komuna mban së paku dy takime publike brenda vitit për çështje të interesit të përgjithshëm	Spektori për marrëdhënie me publikun në: - webfaqen e zyrtare të Komunës - rrjetet sociale - media të shkruara dhe elektronike - vendet e frekuentuara brenda teritorit të Komunës	Salla e Kuvendit të Komunës apo edhe salla të përshtatshme për pjesëmarrjen e qytetarëve	Njoftimi bëhet 2 javë para takimit për takimet me publikun
6.	<i>Takimet dhe intervistat e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ dhe gazetarë</i>	Kryetari i Komunës në kuadër të kompetencave të veta relaizon takime me qytetarë, OJQ dhe gazetarë: - në formë debati - intervistë - konferenca - takime në zyrën e	Shefi i Kabinetit të Kryetarit dhe Spektori për marrëdhënie me publikun në: - webfaqen e zyrtare të Komunës - rrjetet sociale - media të shkruara dhe elektronike - vendet e	Salla e Kuvendit të Komunës apo edhe salla të përshtatshme për pjesëmarrjen e qytetarëve, në zyrë, Radio apo TV.	Njoftimi bëhet 2 javë para takimit apo shfaqjes së intervistës.

		kryetarit (një ditë brenda javës)	frekuentuara brenda teritorit të Komunës		
7.	<i>E drejta e qasjes në dokumente publike</i>	Kërkesat për qasje në dokumente trajtohen nga cilido institucion publik që posedon dokumentin dhe mbikëqyrë informatën	Zyrtari i caktuar për qasjen në dokumentet publike	Kërkesat parashtrohen me shkrim ose në formë elektronike	Komuna nxjerrë Vendim brenda 7 ditë pune nga dita e marrjes së kërkesë për lejimin/,moslejimin e qasjes në dokumentet zyrtare
8.	<i>Kërkesë për informim, iniciativat qytetare dhe petitionet</i>	Personi fizik dhe juridik ka të drejtë të parashtroj kërkesë për realizimin e ndonjë të drejte, iniciativat qytetare dhe petition për çështje që janë përgjegjës organet e Komunës. Partneriteti qytetarë-Komunë	Shefi i Kabinetit të Kryetarit dhe Sektori për marrëdhënie me publikun	Kërkesat parashtrohen me shkrim ose në formë elektronike	Shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës në afat prej 60 ditësh sipas nenit 70 të Ligjit nr. 03/L-040- për vetëqeverisje lokale
9.	<i>Publikimi i akteve komunale</i>	Publikohen të gjitha Vendimet, Rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk	Sektori për marrëdhënie me publikun	Webfaqja zyrtare e Komunës	Publikohen 15 ditë pas regjistrimit në MAPL

		kufizohet sipas ligjit për qasje në dokumentet publike			
10.	<i>Freskimi i web-faqës zyrtare të Komunës</i>	Freskimi i Webfaqës zyrtare të Komunës sikur që pëcaktohet me Udhëzimin Adminsitrativ(MAP) nr. 01/2015 për UEB faqet e institucioneve publike	Spektori për marrëdhënie me publikun dhe zyrtari për IT	Webfaqja zyrtare	
11.	<i>Qasja e shërbimeve për qytetarët transparent dhe shpejtë</i>	Publikimi i procedurave në webfaqe dhe me anë të broshurave për shërbimet dhe procedurat në Komunë për marrjen e dokumenteve të ndryshme për qytetarët	Spektori për marrëdhënie me publikun dhe Spektori i Gjendjes civile	Webfaqja zyrtare Broshura	
12.	<i>Prokurimi transparent</i>	Publikohen: - njoftimet për kontratë - njoftimet për dhënien e kontratë - njoftimet për nënshkrim të kontratës - njoftimet për konkurs të projektimit - njoftimet për anulim - kontratat e	Drejtatori i Prokurimit	- webfaqen e zyrtare të Komunës te linku i Prokurimit - web faqen e KRPP-së (E-prokurimi)	Të gjitha njoftimet e prokurimit bëhen sipas afateve ligjore në fushat e prokurimit.

		nënshkruara - njoftimet për vazhdimin e afatit dhe dokumente të tjera të prokurimit			
13.	<i>procedurat e rekrutimit transparent</i>	- Shpallja e konkursit - njoftimet për përzgjedhjen e kandidatëve - njoftimin për anulimin e konkursit -avancimi brenda institucionit	Sektori për marrëdhënie me publikun	- webfaqen zyrtare të Komunës - në tabelen e shpalljeve të Komunës	Publikimi dhe zbatimi i procedurave të shërbimit civil bëhet në përputhje me legjislacioni në fuqi të shërbimit civil si afatet për shpalljen e konkursit, njoftimi i kandidatve, vazhdimi i konkursit etj,
14.	<i>shpalljet për subvencionim transparente</i>	- shpalljet për subvencionim për persona juridik dhe fizik - shpallja e listës së përfituesve	Sektori për marrëdhënie me publikun	- webfaqen zyrtare të Komunës - në tabelen e shpalljeve të Komunës	Njoftimet apo publikimi i procedurave për subvencionim bëhen me kohë sipas dispozitave ligjore në fuqi

15.	<i>Njoftimet me raportet e organizatave tjera dhe takimet e Kryetarit sipas rregullativës ligjore</i>	Publikohen: - raporti i auditimit - raportet e drejtorateve - raportet e Kryetarit - raportet e përformancës - njoftimet lidhur me takimet e Kryetarit me KKSBB-në dhe takime tjera.	Spektori për marrëdhënie me publikun Shefi i Kabinetit	Webfaqja zyrtare Tabela e Shpalljeve	
16.	<i>Dita e hapur për qytetar</i>	Në një ditë të caktuar brenda vitit Komuna mund të vizitohet nga qytetarët dhe grupe të ndryshme të cilat kanë interes të shohin punën dhe procedurat që zhvillohen. P.sh. nga grupe të organizuar të nxënësve, student etj	Spektori për marrëdhënie me publikun dhe Kabineti i Kryetarit	Objekti i Komunës	Caktohet 1 ditë brenda vitit. Qytetarët njoftohen 30 ditë para kësaj dite.
17.	<i>Transmetimi i drejtëpërdrejtë i seancave të Kuvendit të Komunës në Livestream</i>	Transmetohen senacat e Kuvendit të Komunës të cilat mund të përcillen nga qytetarët nëpërmjet	Spektori për marrëdhënie me publikun dhe zyrtari për IT	Salla e Kuvendit të Komunës, Rrjetet sociale	

		internetit.			
18.	<i>Konsultimi i publikut para miratimit të akteve të Komunës</i>	Publikohen dhe mbahen diskutime publike me qytetar dhe organizata joqeveritare për aktet e Kuvendit të Komunës që janë me interes për qytetaret para miratimit në Kuvendin e Komunës në mënyrë që të gjithë qytetaret dhe organizatat joqeveritare të kenë mundësi të japi vërtetimet e tyre në hartimin e akteve të Kuvendit të Komunës	Sektori për marrëdhënie me publikun dhe zyrtari për IT	Webfaqja zyrtare e Komunës Salla e Kuvendit të Komunës apo edhe salla të përshtatshme për pjesëmarrjen e qytetarëve	Njoftimet bëhen me kohë sipas dispozitave ligjore në fuqi
19.	<i>Numri kontaktues si dhe emaili zyrtar i Komunës</i>	Publikimi i numrit kontaktues ka për qëllim bashkpunimin mes qytetarëve dhe administratës komunale të	Sektori për marrëdhënie me publikun dhe zyrtari për IT	Webfaqja zyrtare të Komunës	

		cilëve u jepet e drejta për të paraqitur kërkesë apo ankesë dhe për t'u informuar me shërbimet e Komunës si dhe emaili zyrtar (infokomuna.li pjan@rks-gov.net) ku qytetarët mund të shkruajnë dhe të adresojnë pyetje për administratën Komunale			
--	--	--	--	--	--

15Nr. 030-36024
Lipjan, më 31. 05. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

